



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/64

Datë: 12.02.2021


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24 të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, në zbatim të pikës 1.10 të Vendimit Nr. 06/58, datë 14.01.2021, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej një milionë e pesëqind mijë euro (1,500,000.00 €) për mbulimin e kostos së tarifës së Fondit për Garanci Kreditore, në zbatim të pikës 1.10, nënpikës 2, të Vendimit Nr. 06/58, datë 14.01.2021, si dhe Nenit 7 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit (Subvencionim të Tarifës së Garancisë) Nr. 2364, datë 31.12.2020.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi merren nga "Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike", me kod 29300, kategoria e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere dhe transferohen të nën-programi "Thesari" me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere, me qëllim të transferimit të tyre të organizata jo-buxhetore Fondit Kosovar për Garanci Kreditore.
3. Autorizohet Thesari që, mjetet e ndara sipas paragrafit 2. të këtij vendimi, në pajtim me nenin 24, paragrafi 3 i Ligji Nr. 07/L-041 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, si dhe bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit Nr. 2364, të nënshkruar me datë 31.12.2020, në mes të Ministrisë së Financave dhe Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, t'i transferojë në llogarinë e dedikuar të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, me emërtim FKGGK - Llogaria Operative, në Bankën Qendrore të Kosovës, në pajtim me legjislacionin dhe qëllimin e përdorimit të këtyre mjeteve.
4. Obligohet Ministria e Financave dhe Thesari i Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HOTI**



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/64

Datë: 12.02.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, nenit 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, të nenit 24 të Ligji Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Lirohen plotësisht (100%) nga pagesa e tarifës së shkollimit për regjistrimin e semestrit veror të vitit akademik 2020-2021 studentët e nivelit baçellor në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, të cilët nuk kanë përfituar nga skemat ekzistuese për lirim nga pagesa deri në kohën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
2. Lirohen nga pagesa e 50% të tarifës së shkollimit për regjistrimin e semestrit veror të vitit akademik 2020 - 2021 studentët e nivelit master të cilët studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës dhe që nuk përfitojnë lehtësira në bazë të skemave ekzistuese për lirim nga pagesa deri në kohën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
3. Përfitues nga lirimi nga pagesa sipas tarifave të përcaktuara në paragrafin 1 (një) dhe 2 (dy) të këtij vendimi janë edhe studentët nga Lugina e Preshevës dhe nga Mali i Zi, të cilët studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ndahen mjete financiare në vlerë prej tremilionëedyqinde tridhjetedy mijë euro (3,232,000.00 €) për mbulimin dhe kompensimin e të hyrave vetanake për secilin institucion publik të arsimit të lartë në Kosovë (MASH - programet e Universiteteve Publike si dhe Universiteti i Prishtinës), bazuar në ndikimin faktik të këtij vendimi, si pasojë e lirimit të pagesës së semestrit veror, sipas këtij vendimi.
5. Mjetet nga pika 4. e këtij vendimi merren nga "Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike", me kod 29300, kategoria e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere dhe transferohen përkohësisht te nën-programi "Thesari" me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere.
6. Mjete e ndara në pikën 5. të këtij vendimi, sipas kërkesës formale të organizatave buxhetore, ndahen dhe alokohen në organizatat buxhetore përkatëse me kod 208/MASHT dhe 242/Universiteti i Prishtinës, bazuar në listat emërore dhe kalkulimet përkatëse për lirimet nga pagesa e semestrit sipas vendimit në pikat 1 deri 3, të konfirmuar nga Rektori dhe Ministri i Arsimit dhe Shkencës, respektivisht.

7. Autorizohet Ministria e Financave dhe Thesari që bazuar në pikën 6. të këtij vendimi, të bëjnë ndarjen dhe alokimin e mjeteve brenda vitit fiskal, deri në limitin e ndarjes buxhetore të përcaktuar në pikën 4. të këtij vendimi, duke respektuar kufirin e planifikimit buxhetor nga fondi burimor të hyrat vetanake (21) sipas Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021 dhe në kategorinë e njëjtë ekonomike.
8. Në rast se rezulton se shuma e mjeteve të ndara sipas këtij vendimi është me e lartë se shuma e nevojshme për kompensim të të hyrave vetanake sipas pikës 4. të këtij vendimi, mjetet buxhetore kthehen te "Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike", me kod 29300, kategoria e shpenzimeve Subvencione dhe Transfere.
9. Obligohet Ministria e Financave, Thesari i Kosovës, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Prishtinës për zbatimin e këtij vendimi.
10. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

### A r s y e t i m

Këto masa të lirimit respektivisht zbritjes nga pagesa e tarifës për shkollim në institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë, merren në kuadër të masave të Qeverisë së Republikës së Kosovës për përkrahjen e funksionimit të arsimit të lartë në kushte të pandemisë Covid - 19. Gjithashtu, nga Programi i Rimëkëmbjes për ndikimin nga lirimi i semestrave sipas këtij vendimi, shtohet buxheti tek Organizatat buxhetore (me programet dhe nën-programet përkatëse buxhetore dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve), bazuar në të dhënat e siguruar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Prishtinës.

**Avdullah HOTI**



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

#### **Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 03/64

Datë: 12.02.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24 të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi Nr. 06/58 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i datës 14.01.2021, si në vijim:
  - 1.1. Pika 1.14, Masa 14, riformulohet dhe zëvendësohet: Në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, në nën-programin Ndërmarrësia, do të ndahen mjete në shumë 8,000,000 € (tetë milionë euro), për subvencionimin për tarifën e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë (BRE), në përputhje me nenin 15 të Ligjit Nr. 07/L-016 për Rimëkëmbjen Ekonomike - Covid-19.
  - 1.2. Pas pikës 1.16, si pikë 1.17, shtohet Masa 17, me këtë formulim: Mjetet në vlerë prej 8,000,000 € (tetë milionë euro), nga pika 1.14 e këtij vendimi, do të mbeten si të pabalokuara (Kontigjencë) te Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike, dhe ndahen sipas nevojës, për mbulimin e kërkesave të natyrës së pandemisë dhe rimëkëmbjes ekonomike, sipas legjislacionit në fuqi.
2. Të gjitha dispozitat tjera të Vendimit Nr. 06/58 të Qeverisë së Republikës së Kosovës mbeten në fuqi.
3. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 04/64

Datë: 12.02.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 12 shkurt 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Pika 2 e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/62 të datës 09.02.2021, riformulohet si në vijim: "Mjetet e parapara sipas pikës një (1) të këtij vendimi merren nga nen-programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria e Rezervës dhe transferohen në nen-programin 003/Invalidët e Luftës - Kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve, pas së cilës transferohen në Shoqatën e Invalidëve të Luftës së UÇK-së, në xhirollogarinë e Procredit Bank nr. 1110003683000163".
2. Pjesa tjetër e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/62 të datës 09.02.2021 mbetet e njëjtë.
3. Obligohet Ministria e Financave, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**A r s y e t i m**

Vendimi i Qeverisë nr.01/62 i datës 09.02.2021 nuk e ka saktësuar së në cilin nen-program buxhetor dhe kategori të shpenzimeve barten mjetet nga nen-programi Shpenzimet e Paparashikuara para së të transferohen të Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së.

**Avdullah HOFI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë